



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena / Predata Received / Delivered	05.05.2021	1	viti god year
Organ / Qësia Organ / Jedinita Org / Unit	Hi / Pret Hi / Pret Prot No	Shtesa Pritje Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	21/89/2021		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.172/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani - anëtarë, me Çlirim Zeka - Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.172/2021 të datës 22.03.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr. "Dimitrije Tucovic" Komuna e Lipjanit, kundër Vendimit me Nr. 151 të datës 11.03/2021 të Komisionit Disiplinor të Qendrës Korrektuese për Femra në Lipjan, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3. dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.05.2021,unanimisht mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.172/2021 e datës 22.03.2021 e parashtruar nga ankuesja**
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.151 i datës 11.03.2021 i Komisionit Disiplinor të Qendrës Korrektuese për Femra në Lipjan.**
- III. Obligohet Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, të shqyrtoj kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj me numër reference 01/2021 të datës 01.02.2021 dhe kërkesën me numër reference 02/2021 të datës 12.02.2021 të U.d. Udhëheqëses se Administratës.**
- IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që ekzekutimi i këtij vendimi të behët në afatin e përcaktuar në pikën tre (III) të këtij dispozitivi.**
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**



Arsyetim

Ankuesja Zyrtare Korrektuese në Qendrën Korrektuese të Femrave në Lipjan, më datë 22.03.2021 ka parashtruar ankesë në numër protokoli 1297/2021 e regjistruar me A.nr.172/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.151 të datës 11.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Qendrës Korrektuese për femra në Lipjan, me të cilën i është shqiptuar masë disiplinore "Ndalim i të ardhurave personale prej 20% e pagës për periudhë kohore prej tre (3) muaj".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës më datë 30.03.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të Shërbimi Korrektues i Kosovës. Këshilli më datë 08.04.2021 në formë elektronikë ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.03.2021 me nr. Protokoli 1297/2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me Nr. 151 të datës 11.03/2021 të Komisionit Disiplinor të Qendrës Korrektuese për femra në Lipjan/Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.03.2021; përgjigje në ankesë e datës 08.04.2021 nëpërmjet E-mailit nga R.H. për C.Z. nga Shërbimi Korrektues i Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Kontratë Pune me Kohë të Caktuar e datës 01.07.2018; Rekomandimi për përtëritjen e kontratës së datës 25.05.2018; Inicim i procedurës disiplinore ndaj zyrtares korrektuese

datës 01.02.2021; Dëshmi fotografi qese e zezë me specia dhe një domate; Njoftim i datës 01.02.2021; Ftesë për Komisionin Disiplinor për i datës 25.02.2021; Vendim i datës 12.03.2021; Ftesë për Komisionin Disiplinor i datës 01.02.2021; Informatë e datës 10.02.2021; Mungesë në Punë e datës 02.02.2021, 05.02.2021, 06.02.2021, 09.02.2021; Ndërrimi i natës Qendra Korrektuese për femra në Lipjan i datës 02/03.02.2021; Ndërrimi i ditës Qendra Korrektuese për femra në Lipjan i datës 05.02.2021; Ndërrimi i natës Qendra Korrektuese për femra në Lipjan i datës 06.02.2021; Ndërrimi i ditës Qendra Korrektuese për femra në Lipjan i datës 09.02.2021; Raporti i Ndërprerjes së Përkohshme për Punë Enti Shëndetësor QKMF Lipjan prej datës 02.02.2021 deri më datën 09.02.2021; Inicimi i procedurës disiplinore ndaj zyrtares Korrektuese i datës 12.02.2021; Vlerësimi i Rezultateve në Punë i datës

10.12.2019; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë viti 2020; Aktvendim mbi formimin e komisionit disiplinor i datës 12.08.2020; Certifikatë e datës 25.09.2007; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar e datës 03.07.2017; Certifikatë e datës 10.07.2006; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar e datës 02.02.2019; Diplomë me numër nr.1275 i datës 30.12.2008; Akt Emërimi i datës 08.08.2016; Shkresë Zyrtare e datës 01/02/20/21; Shënim Zyrtarë i datës 22.01.2021; Shënim Zyrtarë nga mbikëqyrësja me nr.0008; Deklaratë e datës 22.01.2021; Deklaratë e datës 01.02.2021; Kërkesë nga e datës 29/30.01.2021; Dorëheqja e oficeres korrektuese

e datës 01.02.2021; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 04.02.2021; Procesverbal i dëgjimit disiplinor i datës 02.03.2021; Procesverbal i datës 03.03.2021; Dëshmi CD-ja e incizimit të rastit të

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së e ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020, përkatësisht nenin 4 paragrafit 1 dhe 2 me të cilin është përcaktuar se: 1. *Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë.* 2. *Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve,* ka konstatuar se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit profesional të shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civil me status të veçantë, dhe se çështjet e caktuara nga marrëdhënia e tyre e punës mund të rregullohen me Ligj të veçantë sektorial.

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht sipas Kontratës së Punës të datës 01.07.2018, Kolegji ka konstatuar së ankuesja është e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pozitën Zyrtare Korrektuese në Qendrën Korrektuese të Femrave në Lipjan.

Me datë 01.02.2021, Udhëheqësja e Administratës ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankueses, me supozimin se e njëjta ka bërë shkelje të nenit 46 pika 3.3 dhe 3.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe përfitim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës.

Po ashtu Udhëheqësja e Administratës me datë 12.02.2021 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankueses për shkak të supozimit se ankuesja ka bërë shkelje sipas nenit 46 pika 3.5 braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë.

Komisioni Disiplinor i Qendrës Korrektuese për femra në Lipjan, ka shqyrtuar te dy kërkesat e U.d Udhëheqëses së Administratës dhe me Vendimin me numër Nr. 151 të datës 11.03.2021, ndaj ankueses ka shqiptuar masën disiplinore " ndalim i të ardhurave personale prej 20% të pagës për një periudhë kohore prej tre (3) muaj". Kundër këtij vendimi ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Përvarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimorë së vendimi i atakuar nuk është i bazuar.

Në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 49 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse,* Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se Komisioni Disiplinor i Qendrës Korrektuese për femra në Lipjan i themeluar sipas Vendimit me numër protokollit 322 të datës 12.08.2020 të Drejtorit të Qendrës Korrektuese të Femrave në Lipjan, nuk posedon autorizim

ligjor për të shqyrtuar dhe vendosur për raste disiplinore, Andaj, mbi këtë bazë rezulton së një akt administrativ i nxjerrë në mungesë të autorizimit ligjor apo nga organi i cili nuk ka kompetencë, është akt i paligjshëm ashtu siç është përcaktuar me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 52 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe 1.2 ku është përcaktuar se: *1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ve në dukje faktin së Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues si Komision Qendror i Shërbimit Korrektues të Kosovës, duhet të shqyrtoj të gjitha rastet e procedurave disiplinore të të gjitha qendrave të Shërbimit Korrektues, dhe së më rastin e shqyrtimit të kërkesave të specifikuara si në dispozitiv të këtij vendimi duhet të veprojë në pajtim me 48 paragrafët 3, 4, 5, 6, dhe 7 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, si dhe në pajtim me nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve publikë, ku përcaktohet se" *1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.172/2021

Çlirim ZEKA

Çlirim ZeKa
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

